



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 16 Prot.

Tiranë, më 06 /01/ 2022

V E N D I M

Nr. 2 , Datë 06 /01/ 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.238 Regj, datë 20.12.2021, paraqitur nga ankuesi F.M, kundër Bashkisë Korçë përkatësisht nga Zyra e Urbanistikës dhe Komisioni i Vlerësimit, si dhe nga Administratori i Njësisë Administrative Kamenicë, Korçë me pretendimin për diskriminim për për “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi është banor i fshatit Kamenicë dhe në qershor 2019, banesa e tij është shkatërruar nga tërmeti. Në këtë periudhë, ankuesi shpjegon se pranë banesës së tij ka shkuar Komisioni i Vlerësimit bashkë me Kryeplakun, të cilët konstatuan dëmin që kishte pësuar shtëpia. Pas disa ditësh, pranë banesës së tij ka shkuar Kryetari i Bashkisë Korçë, së bashku me Administratorin dhe Kryetarin e Partisë. Sipas ankuesit, Kryetari i Bashkisë pasi kishte parë gjendjen e banesës së tij, kishte folur me Administratorin për të pajisur ankuesin me leje për prishjen e banesës. Pasi u pajis me lejen për prishjen e banesës, ankuesi deklaroi ka i ka shkuar edhe policia e cila i ka kërkuar që të prishte banesën.

Në këto kushte, ankuesi deklaroi se realizoi prishjen e banesës, ndërkohë që interesohej në mënyrë të vazhdueshme nëse kishte ardhur fondi. Për rreth një vit e gjysëm ankuesi shprehet se është interesuar vazhdimisht dhe në momentin që fondi kishte ardhur, ai konstaton se emri i tij nuk ishte i përfshirë, ndërkohë që shokët e tij e kishin. Ankuesi deklaroi se ka bërë ankesë pranë zyrës përkatëse të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve nga tërmeti, pranë Bashkisë Korçë, por nuk ka marrë përgjigje. Ankuesi është interesuar edhe pranë Zyrës së Urbanistikës pranë Bashkisë Korçë,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

të cilët i kanë komunikuar se nuk ka kërkesë në emrin e tij. Sipas ankuesit, Zyra e Urbanistikës pranë Bashkisë Korçë, i ka komunikuar se duhet të dërgojë dokumentat në Ministrinë e Brendshme, pasi ky institucion është përgjegjës për këtë punë. Ankuesi deklaron se dokumentacionin e ka dërguar edhe pranë Ministrisë së Brendshme, por nuk ka marrë përgjigje.

Ankuesi shprehet se ka bërë ankesë në Portalin e Bashkëqeverisjes, nga ku ka marrë përgjigjen si vijon: *“Zyra e Urbanistikës njofton se qytetari ka njoftuar për dëmtimet nga tërmeti në dt.22.11.2019 dhe kur komisioni ka shkuar për verifikim, objekti i vjetër ishte prishur dhe ishte në përfundim objekti i ri. Komisioni i ndodhur në këto kushte e kishte të pamundur të bënte vlerësimin e dëmeve dhe kjo është arsyeja pse nuk është përfshirë në listën e dëmshpërblimeve”*. Ankuesi ka verifikuar listën e miratuar nga Këshilli Bashkiak, por përsëri emri i tij nuk është përfshirë.

Sa më sipër, ankuesi shprehet se ndihet i diskriminuar sepse të gjithë e kanë marrë pjesën e dëmshpërblimit, ndërsa ai jo. Ankuesi pretendon se shkak për këtë ka qenë administratori i cili nuk e ka futur emrin e tij në listë për shkak se ata kanë patur konflikte familjare, në rang krushqie. Ankuesi kërkon nga Komisioneri që përfundimisht të konstatoj faktin e diskriminimit të tij, si dhe rimbursimin e dëmit për banesën e tij në bazë të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesi F.M ka depozituar pranë Komisionerit ankesën nr.238 regj., datë 20.12.2021, kundër Bashkisë Korçë përkatësisht nga Zyra e Urbanistikës dhe Komisioni i Vlerësimit, si dhe nga Administratori i Njësisë Administrative Kamenicë, Korçë, në të cilën pretendon se është diskriminuar, pasi nuk ka përfituar kompesim financiar për mbulimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e tij, nga tërmeti i datës 01.06.2019, ndërkohë që persona të tjerë banorë në të njëjtin fshat, kanë përfituar kompesim financiar për dëmet e shkaktuara nga ky tërmet.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “c” të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankesë tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet

pasi për të njëjtën çështje është marrë një vendim i mëparshëm nga Komisioneri dhe nuk ka të dhëna të reja, bazuar në arsyetimin vijues.

Rezulton se ankuesi F.M për të njëjtat pretendime dhe ndaj të njëjtëve subjekte ka paraqitur edhe më parë ankesë pranë Komisionerit. Konkretisht, ankuesi ka paraqitur ankesën nr.89, datë 17.05.2021, në të cilën ka pretenduar diskriminim nga ana e Bashkisë Korçë, por pa identifikuar ndonjë shkak diskriminues. Me vendimin nr. 87, datë 27.05.2021, Komisioneri ka vendosur mospranimin e ankesës, si të papajtueshme me dispozitat e ligjit, bazuar në nenin 33/4/b, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Më pas, rezulton se ankuesi ka paraqitur ankesën nr.199, datë 03.11.2021, kundër Bashkisë Korçë, përkatësisht Zyra e Urbanistikës dhe Komisioni i Vlerësimit, si dhe Administratorit të Njesisë Administrative Kamenicë, Korçë. Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi është përcaktuar nën opsionin “për çdo shkak tjetër” dhe specifikisht ky shkak konsiston në faktin se ndërmyjet ankuesit dhe Administratorit të Njesisë Administrative Kamenicë, kanë ekzistuar konflikte familjare në rang krushqie. Me vendimin nr.216, datë 15.11.2021, Komisioneri ka vendosur mospranimin e ankesës, si të papajtueshme me dispozitat e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, duke arsyetuar se, shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi nuk është një shkak i vlefshëm dhe nuk ka asnjë lidhje konkrete me pretendimin për diskriminim të ankuesit ndaj Bashkisë Korçë.

Komisioneri vlerëson se, për të njëjtën çështje të bërë objekt shqyrtimi nga ankuesi nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi, Komisioneri e ka marrë një vendim të mëparshëm. Komisioneri vlerëson se, nuk nuk jemi në kushtet kur kemi të dhëna të reja, në mënyrë që të mundësohet marrja në shqyrtim e pretendimeve të bëra nga anakuesi në ankesën objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se për ligjen kërkesat e nenit 33/4/c, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe ankesa e paraqitur nuk mund të pranohet pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33, pika 4, gërma “c”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi F.M, nuk mund të pranohet pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja, e për rrjedhojë ankesa nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “c” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 238 regj., datë 20.12.2021, të paraqitur nga ankuesi F. M, pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: “Çdo shkak tjetër”
Fusha : Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim